



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**  
**Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri**  
**Mbledhja nr. 09**  
**Data 12. 06. 2008**

**P R O C E S V E R B A L**

Mbledhjen e kryesoi:  
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:  
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanovič Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Melihate Termkollli, Agim Veliu, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu dhe Zylfi Merxha

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Biljana Petrović, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me këtë rend dite:

**R e n d i i d i t ë s:**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 29.05.2008
3. Vlerësimi për trajnimin në Gjenevë dhe miratimi i raportit nga kjo vizitë
4. Shqyrtimi i një propozim amendamenti për Projektligjin për Sigurinë Private
5. Të ndryshme

**Pika e parë:** Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

**Pika e dytë:** Procesverbali i mbledhjes së datës 29.05.2008, u miratua pa vërejtje.

**Pika e tretë:** Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i kësaj vizite z.Shkumbin Demalija tha, temat që janë trajtuar gjatë kësaj vizite, kanë qenë mjaft qëlluese dhe të frytshme, ne kemi vizituar edhe Qendrën humanitare, ndërkombëtare për deminim.

**Naim Maloku,** në lidhje me vizitën e komisionit në Gjenevë tha, ne kemi qenë edhe në Qendrën e Gjenevës për politikën e Sigurisë. Konfederata e Zvicrës ka thënë, se do të mbulojë shpenzimet për kurse 3 dhe 6 mujore për kuadro nga Kosova, që do të organizohen në këtë qendër. Pra kjo qendër ka ofruar kurse për kuadro të pakufizuar, dhe

mendoj se do të ishte mirë të shfrytëzohet ky rast, si nga ana e deputetëve ashtu edhe nga përfaqësuesit e MPB-së dhe të shoqërisë civile.

Raporti i vizitës në Gjenevë u miratua pa ndonjë vërejtje.

**Pika e katërt:** z.Emrush Xhemajli në lidhje me këtë, propozim amendament dha sqarimin e tij duke thënë se kjo është një vërejtje që është nxjerr pas vizitës në Gjenevë dhe unë si referues i këtij projektligji pas konsultimit me z.Naim Malokun dhe kryetarin e komisionit e kemi pa, dhe e kemi vlerësuar si vërejtje me vend, pra mendoj se ky amendament duhet të miratohet.

**Eqrem Kryeziu,** kishte një vërejtje rreth formulimit gjuhësor, të këtij propozim amendamenti.

Ky propozim amendament, u miratua me vërejtjen e paraqitur nga z.Eqrem Kryeziu.

**Pika e pestë:** në lidhje me këtë, kryetari i komisionit parashtroj disa çështje, ai theksoi se me rastin e ndërtimit të FSK-së dhe Shërbimit Inteligjent, do të ketë sfida dhe probleme, prandaj kërkohet angazhim më i madh i të gjithë faktorëve në këtë drejtim. Z.Rrustem Mustafa, gjithashtu i njoftoi anëtarët e komisionit, se me 3 korrik Michael Moore, deputet në Parlamentin e Britanisë, pritet të jetë në Kosovë dhe dëshiron një takim me anëtarët e komisionit, ku mund të diskutojmë dhe informohemi mbi rolin e Parlamentit të Britanisë, në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë.

**Naim Maloku,** shtroi dy çështje, ai tha, siç e dini ne e kemi kaluar Ligjin për FSK-në, dhe mendoj se ne duhet ta caktojmë një nën komision, dhe kryesues i këtij nën komisionit të jetë njëri nga nënkryetarët e këtij komisioni. Po ashtu besoi, se tani do të vij edhe projektligji për Shërbimin Inteligjent, dhe kisha kërkuar që ky projektligj të lexohet nga secili prej jush, në mënyrë që të shohim, se a do të jetë kjo nga praktika e shteteve ndërkombëtare, apo si do të ndërtohet.

**Gani Geci,** tha siç e dimë tani do të miratohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe kisha kërkuar që nenet e Kushtetutës, që kanë të bëjnë me FSK-në, Shërbimin Inteligjent etj, të zbatohen ashtu siç parashihen në Kushtetutë. Pra kërkoj që të jemi më të kujdesshëm në zbatimin e këtyre neneve.

**Emrush Xhemajli,** tha me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, shtohen edhe punët rreth komisionit. Ndërsa sa i përket kontrollit të Shërbimit Inteligjent në Kushtetutë parashihet një kontroll mix, por ne duhet të kemi besim në vete pikë së pari dhe besim se me hyrjen në fuqi të Kushtetutës do të bëhet më mirë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Kryetari i Komisionit  
Rrustem Mustafa

